

Mbi procedurat e çregjistrimit të fermerëve

Udhëzimi nr. 19, “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar”, përcakton ndër të tjera edhe procedurat për mënyrën e çregjistrimit të fermerëve.

Fermeri çregjistrohet në mënyrë vullnetare, nëpërmjet aplikimit për çregjistrim, sipas formularit të miratuar për këtë qëllim, duke dorëzuar në të njëjtën kohë certifikatën e NIPT-it në Drejtorinë Rajonale Tatimore, në të cilën kjo certifikatë është lëshuar. Drejtoria Rajonale Tatimore evidenton në regjistrin tatimor datën e dorëzimit të NIPT-it prej fermerit duke e bërë të pavlefshëm këtë NIPT.

Në rast vdekjeje të fermerit, çregjistrimi kryhet me kërkesë të çdo personi të interesuar dhe me depozitim të dokumenteve përkatëse që vërtetojnë që personi është ka vdekur ose është shpallur i vdekur me vendim gjykate, duke dorëzuar në të njëjtën kohë certifikatën e NIPT-it e cila është lëshuar në emrin e tij.

Çregjistrimi i fermerit dhe dorëzimi i certifikatës së NIPT-it në Drejtorinë Rajonale Tatimore, përveç se bëhet për qëllime deklarimi, është i domosdoshëm për të shmangur keqpërdorimin e NIPT-it, pasi bën të pavlefshme çdo faturë tatimore në të cilën ky NIPT është shënuar, të lëshuar pas datës së çregjistrimit të fermerit.

Kujdes!

Personi i tatueshëm, që ka përfituar zbritjen e TVSH-së së shënuar në faturën e lëshuar në emrin dhe për llogari të fermerit të çregjistruar, pas datës që çregjistrimi i tij ka hyrë në fuqi, nuk i lejohet të zbrisë TVSH-në përkatëse dhe ndërkohë nëse e ka zbritur atë TVSH në shkelje të procedurës, i kërkohet të paguajë 100% TVSH-në e zbritur padrejtësisht.